

LIGJ
Nr. 124/2020

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10221, DATË 4.2.2010,
“PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Neni 1, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 1
Objekti

Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”.

Neni 2

Neni 3, ndryshohet, si më poshtë:

“Neni 3
Përkufizimet

1. “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

2. “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

3. “Diskriminim ndërsektorial” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit.

4. “Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.

5. “Diskriminim i shumëfishtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në dy ose më shumë shkaqe që veprojnë veçmas.

6. “Diskriminim strukturor” është ajo formë diskriminimi që u referohet rregullave, normave, praktikave, modeleve të qëndrimeve dhe sjelljeve në institucione dhe në struktura të tjera shoqërore, që në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme paraqesin pengesa për grupet ose individët për të pasur të njëjta të drejta dhe mundësi si të tjerët dhe që kontribuojnë në rezultate më pak të favorshme për ta në raport me të tjerët.

7. “Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme, për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë.

8. “Gjuha e urrejtjes” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshtruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

9. “Mohim i një përshtatjeje të arsyeshme” është ajo formë diskriminimi që ndodh kurdoherë kur ka një mohim ose kundërshtim për të kryer ndryshime ose rregullime të domosdoshme e të përshtatshme, që nevojiten në një rast të veçantë dhe nuk imponojnë një barrë të tepruar, me qëllim që të sigurohet gëzimi dhe ushtrimi në baza të barabarta i të drejtave dhe lirive themelore, të njohura në kuadrin ligjor kombëtar, për personat me aftësi të kufizuara, ose të ndodhur në kushtet e tjera të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

10. “Nxitja ose ndihma për diskriminim” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një ose më shumë persona nxisin ose ndihmojnë një ose më shumë persona të tjerë, duke përfshirë edhe financimin e tyre, me qëllim për të diskriminuar, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

11. “Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.

12. “Qëllimi i shpallur për diskriminim” është ajo formë diskriminimi që ndodh bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, edhe në mungesë të një viktime konkrete.

13. “Shqetësim” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

14. “Shqetësim seksual” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për të.

15. “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim ose kërkesë për të diskriminuar një ose më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji.

16. “Veçimi” është ajo formë diskriminimi, e cila ndodh në rastet kur një person ose grup personash ndahen nga të tjerët pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, dhe kjo ndarje bëhet për të paktën një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1 të këtij ligji.

17. “Viktimizimi” është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim të ankuesit.

Neni 3

Pas nenit 3, shtohet neni 3/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 3/1

Format e rënda të diskriminimit

Çdo sjellje diskriminuese që është motivuar nga më shumë se një shkak, kur është kryer më shumë se një herë, kur ka zgjatur për një periudhë të gjatë kohore, ose kur ka sjellë pasoja veçanërisht të dëmshme për viktimën përbën formë të rëndë të diskriminimit.”.

Neni 4

Në nenin 5 hiqet pika 2.

Neni 5

Në nenin 7, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Autoritetet publike kanë detyrimin për të promovuar barazinë dhe për të parandaluar diskriminimin gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.”.

Neni 6

Në nenin 14 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në titullin e nenit bëhen ndryshimet, si më poshtë:
 - a) togfjalëshi: “Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministrit përgjegjës për punën dhe çështjet sociale”.
 - b) togfjalëshi: “Ministrit të Brendshëm” zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministrit përgjegjës për çështjet e brendshme”.
2. Në paragrafin e parë bëhen ndryshimet, si më poshtë:
 - a) togfjalëshi: “Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministri përgjegjës për punën dhe çështjet sociale”.
 - b) togfjalëshi: “Ministri i Brendshëm” zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministri përgjegjës për çështjet e brendshme”.

Neni 7

Në nenin 18 bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Në titullin e nenit, togfjalëshi: “Ministrit të Arsimit dhe Shkencës” zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministrit përgjegjës për arsimin dhe shkencën”.
2. Në pikat 1 dhe 2, togfjalëshi: “Ministri i Arsimit dhe Shkencës” zëvendësohet me togfjalëshin: “Ministri përgjegjës për arsimin dhe shkencën”.

Neni 8

Në nenin 24 bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Në shkronjën “a”, togfjalëshi: “të ketë cilësi të larta morale” zëvendësohet me togfjalëshin: “të ketë integritet të lartë moral”.

2. Në shkronjën “b”, pas fjalës: “universitare” shtohet togfjalëshi: “të ciklit të dytë ose diplomë të njësuar me të, në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi”.

3. Shkronja “c” riformulohet, si më poshtë:

“c) të ketë eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit;”.

Neni 9

Në nenin 28, në pikën 1, shkronja “b” riformulohet, si më poshtë:

“b) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën për më shumë se tre muaj;”

Neni 10

Në nenin 32 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) në shkronjën “a”, në fund të fjalisë, pas fjalës “ligj” shtohet togfjalëshi: “dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri””.

b) në shkronjën “b”, në fund të fjalisë, pas fjalës “diskriminimi” shtohet togfjalëshi: “ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive”.

c) në shkronjën “dh”, në fund të fjalisë, pas fjalës “ligji” shtohet togfjalëshi: “si dhe të ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri””.

ç) shkronja “i” ndryshohet, si më poshtë:

“i) të paraqesë padi, në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, për çështje që lidhen me interesa kolektive”.

d) pas shkronjës “i”, shtohet shkronja “i/1” me këtë përmbajtje:

“i/1) të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, kur gjatë veprimtarisë së tij konstaton se ligji ose akti normativ cenon të drejtat dhe liritë themelore të individëve.”.

2. Pika 2 riformulohet, si më poshtë:

“2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.”.

3. Në pikën 4, togfjalëshi: “ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”” zëvendësohet me togfjalëshin: “legjislacionin që rregullon të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 11

Në nenin 33 bëhen ndryshimet, si më poshtë:

1. Pika 2 riformulohet, si më poshtë:

“2. Organizata me interesa legjitime mund të kërkojnë kryerjen e hetimeve administrative nëpërmjet disponimit të informacionit të besueshëm, si dhe të përfaqësojnë një person ose grup personash, pasi të jetë marrë pëlqimi me shkrim ose të mbahet procesverbal në prani të një punonjësi të institucionit, për të përfaqësuar personin ose grupin e personave.”.

2. Në pikën 4 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) shkronja “a” shfuqizohet;

b) shkronja “dh” riformulohet, si më poshtë:

“dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijeni për sjelljen diskriminuese.”.

3. Në pikën 5, fjalët: “marrjes së” zëvendësohen me fjalët: “regjistrimit të”.
4. Në pikën 7 bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) fjala “marrjen” zëvendësohet me fjalën “regjistrimin”.
 - b) togfjalëshi “brenda 30 ditëve” zëvendësohet me togfjalëshin: “brenda 10 ditëve pune”.
5. Pas pikës 7, shtohen pikat 7/1, 7/2, 7/3, 7/4 me këtë përmbajtje:

“7/1 Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.

7/2 Kur për konstatimin ose sqarimin e fakteve, që kanë lidhje me shqyrtimin e ankesës, kërkohen njohuri të posaçme, Komisioneri mund të kërkojë mendim të specializuar nga ekspertë të fushave të caktuara.

7/3 Në rastet kur ankesat e paraqitura pranë Komisionerit, drejtuar të njëjtit subjekt, kanë të njëjtin objekt, mund të bashkohen në një ankesë të vetme.

7/4 Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes.”
6. Në pikën 10 togfjalëshi: “dita e marrjes së ankesës” zëvendësohet me togfjalëshin: “dita e regjistrimit të ankesës”.
7. Në pikën 11, fjala “person” zëvendësohet me fjalën: “subjekt”.
8. Në pikën 13, pas shkronjës “ç”, shtohet shkronja “d”, me këtë përmbajtje:

“d) personi fizik ose juridik, i cili kryen një ose më shumë nga format e rënda të diskriminimit, dyfishin e masës së gjobës së parashikuar përkatësisht në shkronjat: “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të pikës 13, të nenit 33.”
9. Pika 16, ndryshohet, si më poshtë:

“16. Në rastet kur vendimi i Komisionerit kthehet mbrapsht nga posta me shënimin “destinacion i panjohur” ose “destinacioni nuk gjendet” dhe për rrjedhim ankuesi dhe subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa nuk mund të marrin dijeni për masat e marra nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përmbledhja e vendimit afishohet në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.”
10. Pika 17, ndryshohet, si më poshtë:

“17. Operatorët mediatikë shtetërorë kanë detyrimin që të publikojnë përmbledhjen e vendimeve të formës së prerë të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me objekt gjuhën e urrejtjes.”
11. Pas pikës 17, shtohet pika 18, me këtë përmbajtje:

“18. Vendimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ankimohen në gjykatën kompetente sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

Neni 12

Pas nenit 33, shtohet neni 33/1, me këtë përmbajtje:

“Neni 33/1

Ekzekutimi i gjobave dhe vendimeve të Komisionerit

1. Gjobat paguhen nga kundërvajtësi jo më vonë se 45 ditë nga komunikimi i tyre. Me kalimin e këtij afati, vendimi i dhënë shndërrohet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përbarimit, me kërkesë të Komisionerit.
2. Gjoba arkëtohet në buxhetin e shtetit.”

Neni 13

Në nenin 34 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3, ndryshohet, si më poshtë:

“3. Një organizatë me interes të ligjshëm mund të paraqesë padi në emër të një personi ose grupi personash, me kusht që organizata të ketë pëlqimin me prokurë të posaçme ose me deklaram përpara gjykatës të personit, ose grupit të personave të dëmtuar nga diskriminimi.”.

2. Pas pikës 3, shtohet pika 4, me këtë përmbajtje:

“4. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe organizatat me interesa legjitime kanë të drejtë të paraqesin padi përpara gjykatës kompetente në mbrojtje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për çështje që lidhen me interesa kolektive.”.

Neni 14

Në nenin 36, në pikën 6, fjala “prova” zëvendësohet me fjalën “fakte”.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 15.10.2020

Shpallur me dekretin nr. 11801, datë 29.10.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta